



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA**  
**KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN**



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik  
VU644-24-298-2-2-1/C844  
14 Nr. 99/24  
Dt. 13.03.2024

## KONTRATË SHËRBIMI

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si Autoritet Kontraktues, të cilën e përfaqëson: **Azize Krasniqi – u.d. e ZPP-s-**( në tekstin e mëtejshëm **PORORSITËSI**) , dhe
2. “ **Enver Mikushnica B.I. “EMRI I BIZNESIT/ “ NSH “DJ ENNO “emri tregtar, me seli në Vushtrri, me ARBK:811111624, të cilën e përfaqëson z. Enver Mikushnica, në tekstin e mëtejshëm: KRYESI I SHËRBIMEVE,**

, janë pajtuar të lidhin këtë kontratë publike për ekzekutimin e shërbimeve dhe / ose punëve, si në vijim: :  
Shërbime me tenda, zërim dhe ndriçim , me numër identifikues:

Nr. i prokurimit	VU644	2	2	2	9	8	2	2	1
Nr. i brendshëm	VU644	2	4	0	0	1	2	2	1

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë : Sigurimi, montimi i tendës, ndriçimit dhe zërimit, si dhe ekzekutimi i shërbimeve dhe / ose punëve tjera, në pajtim dhe në sasi si në Specifikimin Teknikë pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit, ndërsa ekzekutimi i shërbimeve dhe / ose punëve të Porositura duhen të përfundohen në afatin, jo më gjatë se: sipas Porosisë respektivisht Kërkesës së Menaxherit të Kontratës të Autoritetit Kontraktues.
- 1.3 Vendi i rregullimit, montimit, ndiçimit, zërimit, dekorimit etj do të jetë vendi ose vendet e caktuara, në sasi dhe cilësi, sipas rekomandimit të Menaxherit të Kontratës të Autoritetit Kontraktues.
- 1.4 Kjo kontratë është Kontratë Publike Kornizë dhe fillon së zbatuari nga data 13.03.2024 ndërsa përfundon 24 muaj pas nënshkrimit të kontratës respektivisht më dt. 12.03.2026 duke përfshirë dhe këtë datë, dhe e njëjta nuk mundë të zgjatet apo të vazhdohet.
- 1.5 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. Psh, Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Organ tjetër i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Kryesi I Shërbimeve / punimeve, duke specifikuar listen me shërbimet që duhen ekzekutuar, duke përfshirë dhe sasi të tyre përkatëse.
- 1.6 Sasi të shërbimeve dhe ose punimeve të saktësuara si në pjesën II. Lista e Çmimeve, ( pjesë e Dosjes së Tenderit të Kontraktuesit – Kryesit të Shërbimeve ) dhe të kësaj Kontrate nuk janë përcaktuar.
- 1.7 Njësia Kërkuese, Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës i A.K. kanë përgjegjësinë e plotë që të kujdesen që sasi të realizuara ( shpenzuara ) të shërbimeve dhe / ose punëve të porositura të mos ndryshojnë substancialisht në raport me peshën e dhënë sipas grupeve të nëntotaleve si në Përshkrimin e shërbimeve dhe/ ose punimeve si dhe çmimeve, që don të thotë se nuk

duhet të porositen vetëm punët dhe /ose shërbime nga një pozicion apo grup i punëve dhe / ose shërbimeve të caktuar, por porosia duhet të jetë proporcioanle dhe në raport me peshën e dhënë si në Përshkrimin e punëve dhe / ose shërbimeve dhe Çmimeve.

1.8 Autoriteti Kontraktues është i obliguar të përdorë këtë marrëveshje kornizë kurdo që bënë blerjen e shërbimeve dhe/ose punëve të përmendura në nenin 1

1.9 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

## **Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

## **Neni 3 Çmimi**

3.1 Vlera e parashikuar e Kontratës do të jetë në shumë prej: **60,000.00€ ( gjashtëdhjetmij/00 Euro).**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

## **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit teknik të shërbimeve dhe / ose Punëve të ekzekutuara të konfirmuara nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës të Autoritetit Kontraktues.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

## **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

## **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti respektivisht cilësia e shërbimeve dhe / ose punëve duhet, në të gjitha aspektet, të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

## **Neni 7 Garancioni**

7.1 Garancioni për cilësinë, sasinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve të Porositura mbetet përgjegjësi e Kryesit të Shërbimit.

## **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat respektivisht të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve dhe / ose punëve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare



## **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## **Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik**

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

## **Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Komerciale në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin e Kosovës.

## **Neni 14 Komunikimi**

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

14.2 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (c) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);





(d) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

E hartuar në gjuhën Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik:  
NSH "DJ ENNO" – Vushtrri

Për Autoritetin Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë

Emri:	Enver Mikushnica	Emri:	Azize Krasniqi
Pozita:	menaxher	Pozita:	u.d. e ZPP-së
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	13.03.2024	Data:	13.03.2024
Vula:		Vula:	



## KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

VU644-24-298-2-2-1/C844

KOMUNA E VUSHTRRIË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë dhe Enver Mikushnica B.I., Rr.Lidhja e Lezhës nr.121, Vushtrri, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

**Shërbime me Tenda Zërim dhe Ndriqim** me numër identifikues: VU644-24-298-2-2-1

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Lënda ka të bëjë kryerjen e Shërbimeve me Tenda Zërim dhe Ndriqim për aktivitetet kulturore në Komunën e Vushtrrisë për më shumë referoju dosjes së tenderit Aneksi 1 dhe listës së përshkrimt të qmiveve.

1	Shërbime me Tenda Zërim dhe Ndriqim
---	-------------------------------------

Autoriteti kontraktues kryen blerje vetëm në emër të vet

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurorin shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me : 12.03.2024 dhe përfundon në datën : 11.03.2026

1.5 Kontraktuesi do të depozitohet dhe dorëzohet tek A.K. Sigurimin e Ekzekutimit të Kontratës në kohëzgjatje prej 25 muajve nga data e saktësuar për lidhjen e kontratës. Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është : 10 % (dhjetë përqind) nga vlera e përgjithshme e kontratës. Dokumenti – Polisë e sigurimit apo dokument bankar i lëshuar nga ndonjë Bankë apo kompani e sigurimeve të licensuar nga Baka Qendrore e Kosovës.

1.6 Në rast se pas këtij Njoftimi nuk merrni ndonjë njoftim të ri, Ju ftoheni që më dt. 12.03.2024 në orën 14.00 të paraqiteni në zyrën e Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për nënshkrimin e Kontratës.

### Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë : sipas planit dhe afateve të parashikuara dhe dakorduara nga Menaxheri i Kontratës i A.K. dhe Menaxheri i Kontratës i Kontraktuesit, pas lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë : vendi i saktësuar nga Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues.

### Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Vlera totale indikative e kontratës është : 60,000.00Euro. Derivimi nga vlera totale indikative nuk është e lejuar.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësisive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

#### Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimin të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimin të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhën shqipe<sup>1</sup> në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues:  
Komuna Vushtrri

Për: " Enver Mikushnica B.I. " – Vushtrri

<b>Emri:</b>	Azize Krasniqi	<b>Emri:</b>	Enver Mikushnica
<b>Pozita:</b>	u.d. e ZPP-së	<b>Pozita:</b>	menaxher
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	11.03.2024	<b>Data:</b>	11.03.2024
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

<sup>1</sup> Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.



## KUSHTET E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Përkufizimet

1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 “Shërbimet” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “Ofrues i shërbimeve” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “Personeli” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “Çmimi i kontratës” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “Nënkontraktuesi” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “Palë” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

~~1.8 “Autoriteti Kontraktues” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.~~

1.9 “KPK” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguresve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguresit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.



#### **Neni 4 Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Të gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

#### **Neni 5 Tatimi**

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

#### **Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve**

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrin me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktivitetëve.

#### **Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit**

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;

b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

#### **Neni 8 Forca Madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rreshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

~~8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.~~

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

#### **Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjisllacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjete të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;



(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

~~9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.~~

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

#### **Neni 10                   Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve**

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

#### **Neni 11                   Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve**

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai,



duke i ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrimit. Ekzekutimi i urdhrimit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

~~11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.~~

## **Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues**

~~12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.~~

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 13 Dëmet e Likuiduara**

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbrisë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie të pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

#### **Neni 14 Siguria e Ekzekutimit**

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancioni i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

#### **Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit**

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

#### **Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave**

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi



i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

## **Neni 17            Kualiteti i Kontrollit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

## **Neni 18            Përmirësimi i Defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

## **Neni 19            Konsekuencat e Shkeljes se kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:



- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshtëpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumatat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### **Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

#### **Neni 22 Dëmshtëpërblimi**

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbrojë dhe do të dëmshtëpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jetë përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

## KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje ekonomike.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : gjuha e përdorur nga pala
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është me aktvendim të veçantë do të emërohet ditën e nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 10 % e e vlerës së përgjithshme të kontratës në kohëzgjatjen e periudhës prej 25 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të jenë: a) Mjetet motorike të Palës së Tretë [shëno shumen] b) Përgjegjësia e pales së tretë [shëno shumen] c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve : deri 100 % të vlerës së Sigurimit të Ekzekutimit. d) Përgjegjësia profesionale [shëno shumen] Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve :
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Shërbimet e kontraktuara, të përshkruara si në Specifikimin Teknik, do të bëhet vetëm në bazë të kërkesës me shkrim të Njesisë së Kërkesës – Drejtorit të Drejtorisë përkatëse. Cilësia e shërbimeve do të mbikëqyret nga ana e Menaxherit të Kontratës i cili do të emërohet nga ZKA. Menaxheri, përmes Raportit të shkruar, duhet të konfirmoi dhe pranoi ekzekutimin e shërbimeve. Në Raport duhen të evidentohen gjitha të dhënat relevante që janë të nevojshme për përcaktimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga Kryesi i Shërbimeve. Asnjë pagesë në emër të Kryesit të shërbimeve nuk do të autorizohet-lejohet derisa nga Menaxheri i Kontratës i A.K. nuk është përpiluar Raporti për konfirmimin e zbatimit me sukses dhe në mënyrë cilësore të shërbimeve të porositura – kërkuara nga Njësia e Kërkesës, e pasur me Pasqyrën mujore të shpenzimeve të krijuar në drejtorinë përkatëse.
Pagesa	17.1.2	Pagesa për shërbimet e kryera, do të kryhet në bazë mujore, duke u bazuar në raportin e lëshuar nga Menaxheri i Kontratës. Pagesa për shërbimet e kryera gjatë muajit, do të kryhen në muajin pasues.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Bazuar të nenin 20 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në pajtim me ligjin në Kosovë.



Shënim: Te përshkrimi i emimeve duhet plotësuar veçim kolonën E. Në kolonën E, duhet ta plotësojmë me emimin për njësi, po ashtu emimin duhet ta shkruani me tre numra pas pikës (presjes) dhjetore.							
Nr.	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi (DDP - €)	Totali -€		
<b>A 49%</b>							
<b>Shërbimet për binë</b>							
1	Binë profesionale (për skenë) me konstruksion metalik dhe me shtresë nga materiali i përshatshëm për zhvillimin e aktiviteteve kulturore (p.sh. vallëzim) që përdoret për aktivitete të mëdha kulturore, përfshirë edhe konstruksionin për vendosjen e banerit mbrapa. Dhe e cila porositet në bazë të nevojave të aktivitetit kulturor në bazë të metrave katror të nevojshme për aktivitet	m <sup>2</sup>	1	10.00	10.00	(Kategoria A 49% e pikëve në vlersim)	
2	Led ekran për ambiente të hapura. P 3.9 outdoor i cili planifikohet të përdoret në ngjarje të rëndësishme kulturore në dimensione të ndryshme, varësisht prej natyrës së organizimit.						
3	Led ekran për ambiente të hapura. P 3.9 outdoor i cili planifikohet të përdoret në ngjarje të rëndësishme kulturore në dimensione të ndryshme, varësisht prej natyrës së organizimit.	m <sup>2</sup>	1	5.00	5.00		
4	Konstruksion profesional për mbulimin e binës, në rastet kur kërkohet nga organizatori i aktivitetit	m <sup>2</sup>	1	10.00	10.00		
5	Ndriçimi profesional për skenë me ngjyra dhe pajisje ndriçuese robot lëvizëse, që porositet për një aktivitet	Copë	1	500.00	500.00		
6	Ndriçim i bardhë për skenë, që porositet për një aktivitet profesional për skenë, që porositet për një aktivitet	Copë	1	100.00	100.00		
<b>TOTALI A</b>							
					12.50	12.50	
<b>B 45%</b>							
<b>Shërbimet për zërim</b>							
					637.50	637.50	(Kategoria B 45% e pikëve në vlersim)

1	<p>Zërim me kapacitetet mbi 40000 Watts RMS për ambiente të hapura (stadiume, sheshe, palestra sportive e salla të ndryshme).</p> <p>- Pajisjet teknike të nevojshme për një aktivitet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Mix Digital 32 channel – 1 copë;</li> <li>Mix aktive 16 deri 22 channel – 2 copë;</li> <li>Mic (wi – fi) – 25 copë;</li> <li>Mbajtëse për mic – 25 copë;</li> <li>Mic koke (pilot) (wi-fi) – 5 copë;</li> <li>Laptop – 2 copë;</li> <li>Recording profesional për çdo aktivitet (obligativ);</li> <li>Monitor pasiv dhe aktiv për orkestrë – 8 copë;</li> <li>Mic ( me kablo dhe mbajtëse) – 25 copë.</li> <li>Sisteme të zërimit Line Arrays</li> </ol>	shërbim	1	800.00	800.00
2	<p>Zërim me kapacitetet mbi 30000 Watts RMS për ambiente të hapura (stadiume, sheshe, palestra sportive e salla të ndryshme).</p> <p>- Pajisjet teknike të nevojshme për një aktivitet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Mix Digital 32 channel – 1 copë;</li> <li>Mix aktive 16 deri 22 channel – 2 copë;</li> <li>Mic (wi – fi) – 25 copë;</li> <li>Mbajtëse për mic – 25 copë;</li> <li>Mic koke (pilot) (wi-fi) – 5 copë;</li> <li>Laptop – 2 copë;</li> <li>Recording profesional për çdo aktivitet (obligativ);</li> <li>Monitor pasiv dhe aktiv për orkestrë – 8 copë;</li> <li>Mic ( me kablo dhe mbajtëse) – 25 copë.</li> <li>Sisteme të zërimit Line Arrays</li> </ol>	shërbim	1	600.00	600.00
3	<p>Zërim me kapacitetet mbi 20000 Watts RMS për ambiente të hapura (stadiume, sheshe, palestra sportive e salla të ndryshme).</p> <p>- Pajisjet teknike të nevojshme për një aktivitet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Mix aktive 16 channel - 1 copë;</li> <li>Mic (wi – fi) – 5 copë;</li> <li>Mic (me kablo) – 4 copë</li> <li>Mbajtëse për mic – 9 copë;</li> <li>Mic koke (pilot) (wi – fi) - 2 copë;</li> <li>Laptop - 1 copë;</li> <li>Recording profesional për çdo aktivitet (obligativ);</li> <li>Monitor pasiv dhe aktiv për orkestrë - 2 copë;</li> <li>Sisteme të zërimit Line Arrays</li> </ol>	shërbim	1	400.00	400.00
<b>TOTALI B</b>					<b>1,800.00</b>
<b>C 6%</b>	<b>Shërbimet për tenda</b>				<b>( Kategoria C 6% e pikëve në vlersim )</b>



1	3.1. Shërbimi me tendë për një aktivitet të bëhet në bazë të kërkesës për aktivitet, sipas kërkesës së institucionit në bazë të metrave katror	m <sup>2</sup>	1	2.00	2.00
2	3.2 Shërbim me karrige plastike në bazë të kërkesës së institucionit e cila bëhet në bazë të nevojave për karrige për një aktivitet të kërkuara	Copë	1	1.00	1.00
3	3.3 Shërbim me karrige tifen në bazë të kërkesës së institucionit e cila bëhet në bazë të nevojave për karrige për një aktivitet të kërkuara me copë	Copë	1	2.00	2.00
<b>TOTALI C</b>					<b>5.00</b>

<b>REKAPITULIMI</b>			
Nr.	Përshkrimi	Vlera në €	PESHA E NGARKUAR
A 49%	Shërbimet për binë	637.50	312.38
B 45%	Shërbimet për zërim	1,800.00	810.00
C 6%	Shërbimet për tenda	5.00	0.30
Çmimi i Përgjithshëm i peshuar (ofertat do të vlerësohen në bazë të kësaj vlera). Kjo është vlera e cila duhet të shenohet në Formularin e ofertës dhe do të lexohet gjatë hapjes publike.		2,442.50	1,122.68

<b>IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)</b>	
EMRI I OE:	ENVER MIKUSHNICA B.I.
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	ENVER MIKUSHNICA
NËNSHKRIMI:	<i>Enver Mikushnica</i>
DATA:	13.02.2024
VULA:	

Tabela e kalkulimit të çmimit për Kontrat Publike Kornizë - Pune - Çmimi për njësi i peshuar (poentuar), sipas kategorive ku vlera e parashikuar e kontratës është 570,000.00 Euro




LISTA E ÇMIMEVE - PARAMASA DHE PARALLOGARI PUNE-PROJEKTE TE VOGLA NE INFRASTRUKTURE

Lloji I punes

A	PUNET PERGADITORE	Njesia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH ( € )	Çmimi total 49% e pikeve per vlersim	Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë A
<p><b>Verejteje: Operatori Ekonomik eshte i obliguar qe punet pergaditore ti kryej ne perputhshmeri te plote me Nenin 8, nenparagrafet 8.8 dhe 8.9 te Draft-kontrates se dhene ne Dosjen e Tenderit.</b></p>						
1.1	Binë profesionale (për skenë) me konstruksion metalik dhe me shtresë nga materiali i përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve kulturore (p.sh. vallëzim) që përdoret për aktivitete të mëdha kulturore, përfshirë edhe konstruksionin për vendosjen e banerit mbrapa. Dhe e cila porositet në bazë të nevojave të aktivitetit kulturor në bazë të metrave katror të nevojshme për aktivitet	m <sup>2</sup>	1	10.00 €	49%	29,400.00 €
1.2	Led ekran për ambiente të hapura, P 3.9 outdoor i cili planifikohet të përdoret në ngjarje të rëndësishme kulturore në dimensione të ndryshme, varësisht prej natyrës së organizimit.	m <sup>2</sup>	1	5.00 €		
1.3	Konstruksion profesional për mbulimin e binës, në rastet kur kërkohet nga organizatori i aktivitetit	m <sup>2</sup>	1	10.00 €		
1.4	Ndriçimi profesional për skenë me ngjyra dhe pajisje ndriçuese robot lëvizëse, që porositet për një aktivite	copë	1	500.00 €		
1.5	Ndriçim i bardhë për skenë, që porositet për një aktivitet	copë	1	100.00 €		
1.6	Tym profesional për skenë, që porositet për një aktivitet	shërbim	1	12.50 €		
<b>Totali i çmimeve për njësi dhe totali i çmimit total te peshuar, Kategoria A (1.1-1.6)</b>				<b>637.50 €</b>		
B	PUNET E DHEUT, PUNET E RERES DHE ZHAVORIT	Njesia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH ( € )	Çmimi total 45% e pikeve per vlersim	Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë B
2.1	Zërim me kapacitetet mbi 40000 Watts RMS për ambiente të hapura (stadiume, sheshe, palestra sportive e salla të ndryshme). - Pajisjet teknike të nevojshme për një aktivitet: 1. Mix Digital 32 chanel – 1 copë; 2. Mix aktive 16 deri 22 chanel – 2 copë; 3. Mic (wi – fi) - 25 copë; 4. Mbajtëse për mic – 25 copë; 5. Mic koke ( pilot) (wi-fi) – 5 copë; 6. Laptop – 2 copë; 7. Recording profesional për çdo aktivitet (obligativ); 8. Monitor pasiv dhe aktiv për orkestër – 8 copë; 9. Mic ( me kablo dhe mbajtëse) – 25 copë. 10. Sisteme të zërimit Line Arrays	shërbim	1	800.00 €	45%	
2.2	Zërim me kapacitetet mbi 30000 Watts RMS për ambiente të hapura (stadiume, sheshe, palestra sportive e salla të ndryshme). - Pajisjet teknike të nevojshme për një aktivitet: 1. Mix Digital 32 chanel – 1 copë; 2. Mix aktive 16 deri 22 chanel – 2 copë; 3. Mic (wi – fi) - 25 copë; 4. Mbajtëse për mic – 25 copë; 5. Mic koke ( pilot) (wi-fi) – 5 copë; 6. Laptop – 2 copë; 7. Recording profesional për çdo aktivitet (obligativ); 8. Monitor pasiv dhe aktiv për orkestër – 8 copë; 9. Mic ( me kablo dhe mbajtëse) – 25 copë. 10. Sisteme të zërimit Line Arrays	shërbim	1	600.00 €		



2.3	Zërim me kapacitetet mbi 20000 Watts RMS për ambiente të hapura (stadiume, sheshe, palestra sportive e salla të ndryshme). - Pajisjet teknike të nevojshme për një aktivitet: 1. Mix aktive 16 chanel - 1 copë; 2. Mic (wi - fi) - 5 copë; 3. Mic (me kablo) - 4 copë 4. Mbajtëse për mic - 9 copë; 5. Mic koke (pilot) (wi - fi) - 2 copë; 6. Laptop - 1 copë; 7. Recording profesional për çdo aktivitet (obligativ); 8. Monitor pasiv dhe aktiv për orkestër - 2 copë; 9. Sisteme të zërimit Line Arrays	shërbim	1	400.00 €		
Totali i çmimeve për njësi dhe totali i çmimit total te peshuar (2.1- 3.5 )				1,800.00 €	810.00 €	27,000.00 €
C	<b>PUNET E BETONIT, PUNET MONTUESE, PUNET E KONSTRUKSIONIT TE RRUGEVE, INFRASTRUKTURES</b>	Njesia	Sasia	Çmimi njësi me TVSH ( € )	Çmimi total 6% e pikeve per vlersim	Vlera totale e cila lejohet te shpenzohet për kategorinë C
1	3.1. Shërbimi me tendë për një aktivitet të bëhet në bazë të kërkesës për aktivitet, sipas kërkesës së institucionit në bazë të metrave katror	m <sup>2</sup>	1	2.00 €	6%	3,600.00 €
2	3.2 Shërbim me karrige plastike në bazë të kërkesës së institucionit e cila bëhet në bazë të nevojave për karrige për një aktivitet të kërkuara	copë	1	1.00 €		
3	3.3 Shërbim me karrige tiban në bazë të kërkesës së institucionit e cila bëhet në bazë të nevojave për karrige për një aktivitet të kërkuara me copë	copë	1	2.00 €		
Vlera totale e parashikuar				5.00 €	0.30 €	<b>60,000.00 €</b>

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	Azize Krashiqi	Emri:	Enver Mikushnica
Pozita:	Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit	Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	08.03.2024	Data:	08.03.2024
Vula:		Vula:	